



Nr. 547  
dt. 30/10/2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 848, datë 28.10.2020

P Ë R

**STANDARDET, KRITERET E PROCEDURAT E AKREDITIMIT**  
**TË AKTIVITETEVE TË EDUKIMIT TË VAZHUESHËM**  
**TË PROFESIONISTËVE TË SHËRBIMEVE TË KUJDESIT**  
**SHOQËROR, SI DHE TË OFRUESVE TË TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 39, pika 2, 43, pika 4, të ligjit nr.121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Ky vendim përcakton:

- a) standardet, kriteret e procedurat e akreditimit të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm për profesionistët e shërbimeve të kujdesit shoqëror;
- b) standardet, kriteret dhe procedurat e akreditimit të ofruesve të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm për profesionistët e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

2. Në kuptim të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) **“Edukimi i vazhdueshëm”**, procesi nëpërmjet të cilit profesionistët e shërbimeve të kujdesit shoqëror përfitësojnë dijet e aftësitë e tyre për të plotësuar nevojat e përfituesve të këtyre shërbimeve;
- b) **“Profesionist i shërbimeve të kujdesit shoqëror”**, i punësuar në shërbim të kategorive përfituese të shërbimeve të kujdesit shoqëror, si pjesë e sistemit publik e jopublik të ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror;
- c) **“Shërbime të kujdesit shoqëror”**, sistem i integruar dhe i organizuar përfitimesh e lehtësish, të cilat ofrohen nga profesionistë të fushave përkatëse të subjekteve publike ose jopublike, me qëllim sigurimin e mirëqenies, pavarësisë dhe përfshirjes shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror;
- ç) **“Ofrues i akredituar i aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm për profesionistët e shërbimeve të kujdesit shoqëror” (në vijim, “ofruesit”)**, të gjitha strukturat publike ose jopublike, fitimprurëse ose jofitimprurëse, që kanë si objekt veprimtarie ofrimin e aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm për profesionistët e shërbimeve të kujdesit shoqëror në territorin e Republikës së Shqipërisë. Për ofruesit e aktivitetit, të cilët janë subjekte që, sipas legjislacionit në fuqi për lejet e licencat në Republikën e Shqipërisë, kanë detyrimin të jenë të licencuara, provojnë se janë subjekte të pajisura me licencë nga Qendra Kombëtare e Licencave;
- d) **“Kredit i edukimit të vazhdueshëm/kredit”**, treguesi i sasisë dhe i cilësisë së ndjekjes së aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm nga profesionisti i shërbimeve të kujdesit shoqëror;
- dh) **“Konferencë”**, aktivitet 1- (një) deri 3- (tre) ditor për një temë të caktuar, zakonisht e zhvilluar nga shoqata profesionistësh, ku mbahen një seri leksionesh nga ekspertë të fushës, e organizuar në seanca plenare dhe/ose seanca paralele e që ka për qëllim të shtojë njohuritë e audiencës profesionale, kryesisht për të rehat në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror e në lidhje me praktikën përkatëse;
- e) **“Trajnim”**, aktivitet edukues (nga 1- (një) ditor deri në 3- (tre) mujor) që zhvillohet në apo larg vendit të punës e që ka për qëllim përfitim të njohurive, aftësive dhe të shprehive praktike që nevojiten për të përmbushur një detyrë apo punë me cilësi dhe që përfshin përdorimin e metodave të ndryshme pedagogjike dhe jo thjesht mbajtjen e leksioneve;
- ë) **“Workshop”**, aktivitet i zhvilluar me një grup të vogël pjesëmarrësish, të cilët përfshihen aktivisht në diskutime, zgjidhje problemesh ose në kryerjen e një procedure me ndihmën e një eksperti dhe që ka për qëllim

- që pjesëmarrësit të mësojnë, duke provuar, gabuar e korigjuar (vetë ose me ndihmën e të tjerëve) aftësi dhe kompetenca të nevojshme për praktikën e tyre të përditshme;
- f) **“Prezantimi i një leksioni”**, aktivitet që nxit edukimin e vazhdueshëm profesional. Leksioni është një prezantim i një teme të caktuar i mbajtur nga një profesionist i kualifikuar e me përvojë në fushën përkatëse për rreth 20 (njëzet) deri në 40 (dyzet) minuta, i shoqëruar me pyetje-përgjigje;
- g) **“Grup rishikimi”**, aktivitet në grup të vogël (5-10 (pesë deri në dhjetë) vetë), ku profesionistët e të njëjtit specialitet ose shërbim mblidhen rregullisht nën drejtimin e një drejtuesi të paracaktuar të grupit, për të diskutuar për çështje kryesore që lidhen me praktikën e tyre të punës, me cilësinë e shërbimit e zgjidhjet e mundshme dhe që ka për qëllim shkëmbimin e përvojave e vlerësimin e punës së njëri-tjetrit, zgjidhjen e problemeve praktike për të përmirësuar shërbimin;
- gj) **“Aktivitetet e edukimit në distancë”**, aktivitete edukuese që kryhen në mënyrë të pavarur nga profesionisti me ndihmën e teknologjisë moderne nëpërmjet kompjuterit, që e lejojnë profesionistin të ndjekë një program trajnimi me interes për të, pa pasur nevojë për prezencë fizike dhe përshin studimin e materialeve të shkruara, të videokasetave, të video-/telekonferencave, të konferencave dhe komunikimin në një aktivitet të tillë;
- h) **“Aktivitet kërkimor/studimor”**, përfshirja e profesionistit në punë kërkimore, në shkrime artikujsh apo materialesh të tjera profesionale dhe shkencore, që është një formë tjetër e edukimit të vazhdueshëm;
- i) **“Ministër”**, ministri përgjegjës për çështjet sociale;
- j) **“Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm”** funksionon pranë ministrisë përgjegjëse për ndihmën dhe shërbimet shoqërore. Ai është organi më i lartë vendimmarrës në procesin e akreditimit të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm dhe të ofruesve të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm për profesionistët e kujdesit shoqëror. Ky bord mblidhet jo më pak se 4 (katër) herë në vit dhe, për raste të veçanta, kur është e nevojshme, kryetari e mbledh atë edhe më shpesh. Mbledhjet e bordit janë të vlefshme kur në to marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve. Vendimmarrja në Bordin e Edukimit të Vazhdueshëm bëhet me shumicë të thjeshtë;
- k) **“Ekspertët e pavarur”**, ekspertët, që përfshihen në vlerësimin e jashtëm të një aktiviteti të edukimit të vazhdueshëm, zgjidhen me rotacion nga lista e ekspertëve të secilës fushë ekspertize, të miratuar nga Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm. Lista e ekspertëve rishqyrtohet çdo 2 (dy) vjet;

- l) “Ligj”, ligji nr.121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

Çdo term tjetër i përdorur në këtë vendim ka të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në ligjin nr.121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

## II. KUPTIMI I AKREDITIMIT

1. Akreditimi i një aktiviteti të edukimit të vazhdueshëm për profesionistët e shërbimeve të kujdesit shoqëror është procesi i miratimit si aktivitet i akredituar, që bazohet në vlerësimin nëse aktiviteti përmbush standardet e akreditimit të përcaktuar në këtë vendim e që përfshin përcaktimin e krediteve për atë aktivitet.
2. Akreditimi i ofruesit të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm për profesionistët e shërbimeve të kujdesit shoqëror është procesi i miratimit si ofrues i akredituar, që bazohet në vlerësimin nëse ofruesi përmbush standardet e kriteret e akreditimit të përcaktuara në këtë vendim. Për ofruesit e aktivitetit, të cilët janë subjekte që, sipas legjislacionit në fuqi për lejet dhe licencat në Republikën e Shqipërisë kanë detyrimin të jenë të licencuara, provojnë se janë subjekte të pajisura me licencë nga Qendra Kombëtare e Biznesit.
3. Akreditimi i një aktiviteti të edukimit të vazhdueshëm dhe ofruesve të tyre është kompetencë e Qendrës Kombëtare të Edukimit të Vazhdueshëm në varësi të ministrit. Qendra Kombëtare e Edukimit të Vazhdueshëm do të ndjekë të gjitha procedurat për t’u akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në përputhje me standardin ISO/IEC 17024:2012 për të demonstruar kompetencën teknike të saj.
4. Llojet e aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm që akreditohen nga Qendra Kombëtare e Edukimit të Vazhdueshëm janë:
  - a) konferenca;
  - b) trajnimi;
  - c) *workshop*-i;
  - ç) prezantimi i një leksioni;
  - d) grupi i rishikimit;
  - dh) aktivitetet e edukimit në distancë.

### **III. AKREDITIMI I AKTIVITETEVE TË EDUKIMIT TË VAZHdueshëm PËR PROFESIONISTËT E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR**

#### **III.1. Standardet e akreditimit të aktiviteve të edukimit të vazhdueshëm**

1. Akreditimi i aktivitetit të edukimit të vazhdueshëm për profesionistët e shërbimeve të kujdesit shoqëror planifikohet, përgatitet e zhvillohet në përputhje me këto standarde:
  - a) Planifikimi e identifikimi i aktivitetit paraprihet nga një proces i vlerësimit të nevojave të profesionistëve dhe i korrespondon adresimit të këtyre nevojave;
  - b) Qëllimi, objektivat, nevojat për njohuri, aftësi ose cilësitë e aktivitetit janë të mirëpërcaktuara:
    - b.1) Aktiviteti ka për qëllim përmirësimin/ndryshimin e njohurive, aftësive dhe cilësive të profesionistëve e rritjen e performancës së punës së tyre ndaj përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror;
    - b.2) Objektivat e aktivitetit të edukimit të vazhdueshëm janë objektiva të zhvillimit të njohurive dhe aftësive:
      - i. tekniko-profesionale individuale, sipas fushave të veçanta të çdo kategorie apo specialiteti (objektiva të nivelit individual);
      - ii. që mundësojnë cilësi, efikasitet dhe eficiencë më të lartë të punës së profesionistit në institucionin ose shërbimin që ofron.
  - c) Përmbajtja e aktivitetit përputhet me fushën, ku profesionistët pjesëmarrës ushtrojnë profesionin e tyre. Përmbajtja e programit e forma e edukimit (teknikat pedagogjike) të zgjedhura për t'u përdorur për aktivitetin janë të përshtatshme për tematikën dhe sigurojnë arritjen e objektivave e të rezultateve të pritshme të aktivitetit lidhur me përvetësimin e njohurive dhe të aftësive të synuara nga ana e pjesëmarrësve në fund të aktivitetit;
  - ç) Garantimi i aktivitetit. Ofruesi, gjatë zhvillimit të aktivitetit, respekton programin e deklaruar e listën e deklaruar të lektorëve/trajnerëve dhe njofton Qendrën Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm për çdo ndryshim të kryer:



- i. Ofruesi për atë aktivitet garanton vlerësimin real të cilësisë së aktivitetit nga pjesëmarrësit pa ndikuar në këtë vlerësim;
  - ii. Ofruesi për atë aktivitet vlerëson shkallën e arritjes së rezultateve të pritshme dhe të përvetësimit të njohurive dhe aftësive të synuara nga ana e pjesëmarrësve në fund të aktivitetit;
  - iii. Ofruesi për atë aktivitet garanton e siguron regjistrimin, monitorimin dhe dokumentimin e pjesëmarrjes reale të personave të regjistruar për atë aktivitet, përfshirë edhe testimin për njohuritë e marra në përfundim të aktivitetit të akredituar;
  - iv. Ofruesi për atë aktivitet i pajis profesionistët pjesëmarrës me certifikatën e pjesëmarrjes, e cila përmban edhe kreditet përkatëse sipas pjesëmarrjes reale;
  - v. Ofruesi për atë aktivitet mban të ndarë promovimin e aktivitetit nga pjesa edukative e aktivitetit.
2. Përveç sa parashikohet në pikën 2, të këtij kreu, për akreditimin e aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm në distancë aktiviteti planifikohet, përgatitet e zhvillohet në përputhje edhe me këto standarde minimale/bazë specifike:
- a) Infrastruktura për realizimin e aktivitetit. Ofruesi për atë aktivitet u siguron pjesëmarrësve *hardware*-in dhe *software*-in (p.sh. *Windows/MacOS*; lexues *DVD*), që nevojiten për të përdorur materialet, udhëzime për përfitimin maksimal nga aktiviteti, hapësirën fizike me kushte optimale për të nxënë, si dhe të gjitha mjetet e tjera të nevojshme për realizimin e saj;
  - b) Mbështetja dhe orientimi në kohë. Ofruesi për atë aktivitet siguron në kohë reale mbështetje teknike për pjesëmarrësin në lidhje me ndjekjen e aktivitetit;
  - c) Përfshirja dhe përmbushja e objektivave. Ofruesi për atë aktivitet garanton një mënyrë që provon përfshirjen e pjesëmarrësit, si dhe të përmbushjes së objektivave të edukimit në distancë;
  - ç) Konfidencialiteti. Ofruesi për atë aktivitet siguron respektimin e konfidencialitetit të pjesëmarrësit, si dhe garanton që çdo informacion për pjesëmarrësit në aktivitet të përdoret vetëm për qëllimet specifike të përmbushjes së kërkesave të këtij vendimi dhe në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në fuqi;
  - d) Efektshmëria e aktivitetit. Ofruesi për atë aktivitet vërteton që pjesëmarrësit kanë përvetësuar deri në 70% të njohurive të marra gjatë aktivitetit të edukimit në distancë (përqindja kaluese);

dh) Cilësia e burimeve njerëzore. Ofruesi për atë aktivitet vërteton që lektorët/trajnerët e aktivitetit të kenë eksperiencë të mëparshme në mësimdhënie apo t'i jenë nënshtruar një trajnimit paraprak për mësimdhënie, të kenë ekspertizë të gjerë për temën dhe eksperiencë të mëparshme trajnuese.

### III.2 Procesi i akreditimit

3. Aplikimi për akreditimin e aktivitetit të edukimit të vazhdueshëm për profesionistët e shërbimeve të kujdesit shoqëror bëhet në Qendrën Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm, si organi përgjegjës për mbledhjen e tarifave të akreditimit dhe administrimin e të ardhurave që gjenerohen nga ky proces, nga ofruesit e aktivitetit. Për ofruesit e aktivitetit, të cilët janë subjekte që, sipas legjislacionit në fuqi për lejet e licencat në Republikën e Shqipërisë, kanë detyrimin të jenë të licencuara, provojnë se janë subjekte të pajisura me licencë nga Qendra Kombëtare e Licencave.
4. Paraqitja e kërkesës bëhet nga ofruesi jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e planifikuar për fillimin e zhvillimit të aktivitetit për të cilin kërkohet akreditimi. Aplikimi për akreditim shoqërohet me pagesën e një tarife, që varion sipas llojit e kohëzgjatjes së aktivitetit, e cila miratohet nga Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm (në vijim, BEV).
5. Kërkesa, në kuptimin e pikës 4, të këtij kreu, përfshin:
  - a) të dhënat për identifikimin e ofruesit e të dhënat e hollësishme për aktivitetin, sipas aneksit nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;
  - b) dokumentet provuese dhe shoqëruese për të dhënat e deklaruara sipas shkronjës "a", të kësaj pike, sipas aneksit nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij; dhe
  - c) raportin e detajuar të përgatitjes të aktivitetit.
6. Qendra Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm miraton formularin e gatshëm të aplikimit, sipas pikës 5, të këtij kreu.
7. Raporti i detajuar i përgatitjes së aktivitetit pasqyron përgatitjet që ka bërë ofruesi për aktivitetin, si më poshtë vijon:

a) Qëllimi dhe objektivat e aktivitetit të edukimit të vazhdueshëm, të cilët paraqiten nëpërmjet një deklaratë të shkruar, duke përfshirë dhe fushat e ndërhyrjes, audiencën, së cilës i drejtohet, llojin e aktivitetit që do të ofrohet dhe rezultatet e pritshme nga ky aktivitet;

b) Planifikimin e aktivitetit, ku ofruesi:

- i. demonstroi një proces planifikimi të aktivitetit, i cili gërsheton nevojat e identifikuara për edukim të vazhdueshëm me rezultatet e parashikuara të aktivitetit;
- ii. përdori të dhëna të bazuara në vlerësimin e nevojave për hartimin dhe planifikimin e aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm;
- iii. komunikoi qëllimin e objektivat e aktivitetit, në mënyrë që profesionistët pjesëmarrës të jenë në dijeni të tyre para ofrimit të aktivitetit;
- iv. siguron përputhje me politikat e parashikuara për mbështetjen financiare dhe konfliktin e interesit.

c) Vlerësimin e përmirësimin e aktivitetit, ku ofruesi:

- i. parashikon vlerësimin e efikasitetit të aktivitetit të edukimit të vazhdueshëm në përmbushjen e nevojave të identifikuara paraprakisht;
- ii. bën përmirësimet e nevojshme të sugjeruara nga procesi i vlerësimit.

8. Për akreditimin e aktiviteteve që janë akredituar më parë nga Qendra Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm, ofruesi ka detyrimin të dërgojë në Qendrën Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm një njoftim me shkrim, të shoqëruar me programin e aktivitetit, të paktën 7 (shtatë) ditë kalendrike përpara zhvillimit të tij.

9. Për çdo aktivitet të edukimit të vazhdueshëm bëhet një aplikim i veçantë. Përjashtim bëjnë aktivitetet e ofruara/organizuara nga Shërbimi Social Shtetëror/institucionet publike për punonjësit e institucioneve publike, për të cilat bëhet një aplikim i vetëm për të gjitha aktivitetet që do të zhvillojë institucioni publik për punonjësit e vet brenda një viti kalendrik.



10. Aplikimi për akreditimin e aktivitetit të edukimit të vazhdueshëm të organizuar nga Shërbimi Social Shtetëror (në vijim, SHSSH) kryhet në dy faza:
  - a) Faza e dërgimit të aplikimit për akreditim dhe e programit vjetor të aktiviteteve para zhvillimit të aktivitetit. Paraqitja e kërkesës, që përmban programin vjetor të aktiviteteve dhe një paraqitje të shkurtër të tyre (deri në datën 20 janar të vitit përkatës);
  - b) Faza e plotësimit të materialit didaktik, e cila kryhet edhe pas zhvillimit të aktivitetit. Plotësimi dhe dorëzimi në Qendrën Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm i dokumenteve provuese e shoqëruese, të specifikuara në ndarjen III, të aneksit nr.1, të këtij vendimi, që kryhet para, gjatë apo pas zhvillimit të secilit aktivitet.
11. Procedurat e akreditimit për aktivitetet, që SHSSH-ja/institucionet publike kryejnë për punonjësit e vet dhe aktivitetet e organizuara nga urdhrat e profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, janë pa pagesë.
12. Procesi dhe vendimmarrja për akreditimin mbështetet në vlerësimin e brendshëm të kryer nga ofruesi i aktivitetit dhe vlerësimin e jashtëm të kryer nga Qendra Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm.
13. Përpara paraqitjes së kërkesës për akreditim, ofruesi i aktivitetit përgatit një vlerësim të brendshëm të aktivitetit e të organizimit të tij.
14. Vlerësimi i brendshëm kryhet nga vetë institucioni ofrues i aktivitetit të edukimit të vazhdueshëm dhe shërben si bazë për vlerësimin e jashtëm. Ai identifikon nevojat për edukim të vazhdueshëm dhe metodat më të mira për përmbushjen e tyre. Të dhënat e ofruara nga aplikuesi pasqyrojnë me vërtetësi informacione për tre komponentët kryesorë, sipas raportit të përshkruar në pikën 7, të këtij kreu.
15. Vlerësimi i jashtëm kryhet nga Qendra Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm e realizohet nëpërmjet vlerësimit të dokumentacionit para akreditimit (akreditimi fillestar) dhe monitorimit të aktivitetit/vlerësimit përfundimtar (akreditimit përfundimtar).

16. Në fazën e parë të akreditimit fillestar, që kryhet para se aktiviteti të akreditohet e të zbatohet, ndiqen procedurat e mëposhtme:

- a) Qendra Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga aplikuesi dhe, nëse ai është i plotë, bën vlerësimin e tij sipas kriterëve të cilësisë në planifikimin e aktivitetit, përfshirë vlerësimin e burimeve të përdorura (trajnerët e materialet pedagogjike);
- b) Në rast të plotësisë të pjesshëm nga ofruesit të dokumentacionit të kërkuar, Qendra Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm refuzon akreditimin ose nuk vlerëson me kredite ato materiale të programit që kanë mangësi në dokumentacion;
- c) Në përfundim të kësaj faze, Qendra Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm harton një raport paraprak vlerësimi.

17. Në fazën e dytë të procedurës së akreditimit fillestar të aktivitetit të edukimit të vazhdueshëm, një apo disa ekspertë të pavarur të fushës të caktuar nga Qendra Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm kryejnë vlerësimin e përmbajtjes së programit dhe të kurrikulave të aktivitetit, sipas kësaj procedure:

- a) Qendra Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm ngarkon një ose më shumë ekspertë të pavarur të fushës nga lista e përzgjedhur nga BEV-ja për të kryer vlerësimin e përmbajtjes së kurrikulave, që do të përdoren në aktivitet dhe për përputhshmërinë e tyre me nevojat e pjesëmarrësve;
- b) Në varësi të këtij vlerësimi, eksperti/ekspertët sugjerojnë se cilat tema duhen konsideruar ose jo për llogaritjen e krediteve;
- c) Eksperti përgatit raportin e përmbajtjes, i cili përmban mendimin e ekspertëve për kurrikulat dhe kreditet e propozuara për aktivitetin. Në varësi të këtij vlerësimi, eksperti/ekspertët sugjeron/sugjerojnë se cilat tema duhen konsideruar ose jo për llogaritjen e krediteve;
- ç) Qendra Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm paguan ekspertët e pavarur për vlerësimin e kryer prej tyre, bazuar në përcaktimin e orëve të punës, siç paraqiten në aneksin nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- d) Për aktivitete që përdorin materiale trajnuese, të hartuara nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale ose organizata partnere, Qendra Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm i kalon ose jo këto materiale për vlerësim nga eksperti i pavarur i fushës.

18. Në fazën e tretë, bazuar në raportet e përmendura në pikat 16 e 17, të këtij kreu, Qendra Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm vendos për akreditimin fillestar të aktivitetit apo refuzimin e tij. Bazuar në dy raporte të Qendrës Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm dhe të ekspertit/ekspertëve, sipas pikave 16 e 17, të këtij kreu, Qendra Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm vendos nëse aktiviteti akreditohet ose jo.
19. Vendimi për miratimin përfshin edhe numrin e krediteve të miratuara për atë aktivitet, ndërsa vendimi për refuzimin, përveç arsytimit, përfshin edhe sugjerimet përkatëse për përmirësime të nevojshme në vijim.
20. Përlllogaritja e krediteve bëhet nga Qendra Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm në përputhje me aneksin nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
21. Vendimi sipas pikës 19, të këtij kreu, merret dhe i njoftohet aplikuesit brenda një afati 30- (tridhjetë) ditor nga paraqitja e një kërkesë të plotë nga ofruesi.
22. Aktiviteti i akredituar së bashku me kreditet e miratuara për atë aktivitet bëhen publike në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm.
23. Dokumentacioni i vlerësimit të brendshëm dhe ai i vlerësimit të jashtëm, së bashku me numrin e përcaktuar të krediteve, bazuar në llojin e aktivitetit dhe kohëzgjatjen e tij, përbëjnë dosjen e vlerësimit, miratimi i së cilës mbyll procesin e akreditimit fillestar.
24. Për akreditimin përfundimtar, Qendra Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm kryen monitorimin e vlerësimit e zbatimit të standardeve të aktivitetit, të parashikuara në pikat 1 e 2, të kreut III.1, të këtij vendimi.
25. Monitorimi kryhet drejtpërdrejt nga Qendra Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm apo nga ekspertë të pavarur të caktuar prej saj, sipas përcaktimeve në shkronjën "k", të pikës 2, të kreut I, të këtij vendimi.
26. Monitorimi kryhet pa njoftim paraprak e në mënyrë të rastësishme. Në kuadër të monitorimit, Qendra Kombëtare për Edukimin e

Vazhdueshëm apo ekspertët e pavarur organizojnë dhe vlerësimin e aktivitetit nga pjesëmarrësit e saj.

27. Pas përfundimit të aktivitetit për herë të parë, ofruesi paraqet në Qendrën Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm:
  - a) listën e pjesëmarrësve në aktivitet;
  - b) rezultatet e vlerësimit të aktivitetit nga pjesëmarrësit; dhe
  - c) kreditet e përfituara për secilin pjesëmarrës.
28. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga paraqitja e dokumenteve, sipas pikës 27, të këtij kreu, Qendra Kombëtare për Edukimin të Vazhdueshëm kryen vlerësimin përfundimtar në bazë të rezultateve të monitorimit e dokumenteve të paraqitura dhe merr vendim për akreditimin përfundimtar të aktivitetit apo për anulimin e akreditimit fillestar.
29. Nëse nga vlerësimi përfundimtar gjykohet se ka përmbushje maksimale të standardeve të cilësisë dhe/ose vlerësim të shkëlqyer të programit, të lektorëve/trajnerëve dhe të organizimit të aktivitetit nga pjesëmarrësit, Qendra Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm vendos akreditimin përfundimtar me një rritje të krediteve të aktivitetit deri në 20% të krediteve të miratuara në akreditimin fillestar.
30. Akreditimi sipas pikës 29, të këtij kreu, është i vlefshëm për një periudhë 3- (tre) vjeçare nga data e njoftimit të vendimit të akreditimit.
31. Aktivitetet e edukimit të vazhdueshëm me kohëzgjatje jo më shumë se 50 (pesëdhjetë) orë, që kryhen nga ofruesi i aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm i akredituar për një periudhë 5- (pesë-) vjeçare nga Qendra Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm, konsiderohen të akredituara nga Qendra Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm.
32. Ofruesi, në kuptim të pikës 31, të këtij kreu, është i detyruar të zbatojë kriteret, standardet e procedurat e parashikuara në këtë vendim për aktivitetet e edukimit të vazhdueshëm, përfshirë edhe përcaktimin e krediteve të aktivitetit, pa pasur të nevojshme paraqitjen e kërkesës e të dokumentacionit shoqërues e provues pranë Qendrës Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm.

### **III.3 Monitorimi gjatë periudhës së vlefshmërisë së akreditimit të një aktiviteti**

33. Ofruesi i aktivitetit monitoron e vlerëson në vazhdim aktivitetin, si dhe adreson të gjitha dobësitë e identifikuara gjatë procesit të vlerësimit të aktivitetit në procesin e planifikimit të aktiviteve pasardhëse, në përputhje me standardet e akreditimit.
34. Ofruesi i aktivitetit njofton paraprakisht Qendrën Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm për çdo herë që realizon aktivitetin e akredituar dhe për çdo ndryshim të kryer në të dhënat e deklaruara për atë aktivitet.
35. Ofruesi paraqet në Qendrën Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga përfundimi i realizimit të çdo aktiviteti:
  - a) listën e pjesëmarrësve në aktivitet;
  - b) rezultatet e vlerësimit të aktivitetit nga pjesëmarrësit;
  - c) kreditet e përfituara nga secili pjesëmarrës.
36. Qendra Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm monitoron aktivitetin e edukimit të vazhdueshëm, të akredituar ose në proces, për të siguruar zbatimin e standardeve dhe të kriterëve të parashikuara nga profesionistët e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Qendra Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm monitoron, në mënyrë të rastësishme dhe pa njoftim paraprak, vetëm një pjesë të aktiviteve që akreditohen prej saj.
37. Gjithashtu, Qendra Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm realizon vlerësimin e aktivitetit nga pjesëmarrësit në aktivitet. Ajo kryen monitorimin në vazhdim të standardeve të akreditimit në zbatimin e aktivitetit të akredituar gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së akreditimit. Pika 26, e këtij kreu, zbatohet përshtatshëm edhe për monitorimin gjatë periudhës së vlefshmërisë së akreditimit të një aktiviteti.
38. Qendra Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm shfuqizon akreditimin:



- a) për moszhvillimin e aktivitetit të deklaruar pa njoftim paraprak në Qendrën Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm;
  - b) për mosraportimin e konflikteve të interesit të organizatorëve ose/dhe trajnuesve në aktivitet;
  - c) për përdorimin e aktiviteve për promovim personal ose tregtar.
39. Në rast të konstatimit të shkeljeve të përsëritura, Qendra Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm shoqëron vendimin për shfuqizimin e akreditimit me ndalimin e ofruesit për të aplikuar për të njëjtin aktivitet për një periudhë 6- (gjashtë) mujore dhe, në rast shkeljesh të rënda, për një periudhë 1- (një) vjeçare.
40. Rastet e parashikuara në pikën 38, të këtij kreu, konsiderohen shkelje të rënda.

#### **IV. AKREDITIMI I OFRUESVE TË AKTIVITETEVE TË EDUKIMIT TË VAZHDUESHËM PËR PROFESIONISTËT E SHËRBIMEVE SHOQËRORE**

##### **IV.1 Kriteret për akreditimin e ofruesve të aktivitetit të edukimit të vazhdueshëm**

1. Akreditimi i ofruesit të aktivitetit të edukimit të vazhdueshëm bëhet kur përmbushen këto kriteret:
  - a) Të jetë subjekt i licencuar sipas legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet e lejet në Republikën e Shqipërisë;
  - b) Të ketë zhvilluar aktivitete të edukimit të vazhdueshëm, të cilat janë në përputhje me kriteret e standardet e akreditimit të aktiviteve të edukimit të vazhdueshëm, siç përcaktohen në këtë vendim, të vërtetuara me kontrata të ngjashme;
  - c) Të provojë besueshmërinë ekonomike dhe financiare për vazhdimësinë e veprimtarisë, të vërtetuar me bilancin vjetor të vitit paraardhës;
  - ç) Të ketë burimet njerëzore që garantojnë stabilitet të veprimtarisë së tij dhe cilësi në organizimin e menaxhimin e aktiviteve të edukimit të vazhdueshëm, përfshirë:
    - i. një koordinator shkencor përgjegjës për konceptimin e planifikimin e aktiviteve; dhe
    - ii. një komitet shkencor për miratimin e planit të aktiviteve, përfshirë programet e lektorët, i cili ka minimalisht tre



pjesëmarrës: dy persona me kohë të plotë, një profesionist të angazhuar për aktivitetet e edukimit të vazhdueshëm, përgjegjës për zbatimin e sigurimin e mbarëvajtjes së aktiviteteve, dhe një person përgjegjës për menaxhimin/arkivimin e të dhënave dhe të informacionit.

- d) Të ushtrojë veprimtarinë e tij në ambiente që plotësojnë këto kushte:
- i. Të kenë sipërfaqe jo më pak se 50 (pesëdhjetë) m<sup>2</sup>.
  - ii. Të kenë ajër të kondicionuar;
  - iii. Të kenë ndriçim të plotë dhe të garantuar edhe për raste emergjente;
  - iv. Të jenë të aksesueshme për nevojat e personave me aftësi të kufizuara.
- dh) Të disponojë aparaturat/mjetet e nevojshme për realizimin e veprimtarisë;
- e) Të ushtrojë veprimtarinë me normativa të shfrytëzimit të ambienteve jo më shumë së 7.5-8.0 (shtatë pikë pesë deri në tetë pikë zero) m<sup>2</sup>/pjesëmarrës dhe, bazuar në këtë, me përjashtim të rastit të konferencave.
2. Ofruesi paraqet një deklaratë të qëllimit të aktivitetit të edukimit të vazhdueshëm, e cila përmban të gjithë komponentët bazë (objektivat, fushat që do të përfshijë, llojin e aktivitetit, rezultatet e pritshme), ku rezultatet të jenë formuluar bazuar në termat e ndryshimeve që aktiviteti do të sjellë në njohuritë ose praktikën e profesionistëve ose përfitimin e pacientëve.
  3. Ofruesi përcakton se cilat nevoja për edukim të vazhdueshëm, të shprehura në njohuri, kompetenca ose praktika, do të adresohen në aktivitetin e propozuar të edukimit të vazhdueshëm.
  4. Ofruesi harton aktivitete, të cilat kanë për qëllim të ndryshojnë njohuritë, aftësitë, performancën ose përfitimet, të parashikuara në qëllimin e deklaruar të aktivitetit.
  5. Ofruesi harton aktivitete, përmbajtja e të cilave përputhet me fushën, në të cilën profesionistët pjesëmarrës ushtrojnë profesionin e tyre.

6. Ofruesi zgjedh forma edukimi (metoda pedagogjike), të cilat janë të përshtatshme për tematikën, objektivat dhe rezultatet e pritshme të aktivitetit.
7. Ofruesi harton aktivitete që përputhen me tematikën e kompetencave të dëshiruara nga profesionistët (p.sh.: udhëzuesit, standardet apo protokollet e ofrimit të shërbimeve etj.).
8. Për aktivitetet e edukimit në distancë:
  - a) ofruesi deklaron formatin e nevojshëm për përdorimin e materialit (p.sh.: *Windows/MacOS*; lexues *DVD*) dhe ofron detaje për kontaktet për ofrim mbështetjeje (teknike) për pjesëmarrësit, në rastin e aktiviteteve që përdorin teknologjinë e informacionit, *hardware*-in dhe *software*-in, që nevojitet për të përdorur materialet, si dhe instruksione për përfitimin optimal nga kursi;
  - b) ofruesi deklaron kohëzgjatjen në orë të kohës që pjesëmarrësit i nevojitet për të përmbushur objektivat edukativë të aktivitetit;
  - c) ofron mbështetje teknike për pjesëmarrësin, në lidhje me ndjekjen e aktivitetit;
  - ç) garanton një mënyrë për konfirmimin e përfshirjes së pjesëmarrësit, si dhe të përmbushjes së objektivave edukativë;
  - d) respekton e konfirmon konfidencialitetin e pjesëmarrësit, si dhe faktin që çdo informacion për pjesëmarrësit në aktivitet do të përdoret vetëm për qëllimet specifike të përmbushjes së kërkesave të këtij materiali. Rastet e vetme të përjashtimit janë me informimin e miratimin e plotë të pjesëmarrësit;
  - dh) gëzon statusin “ofrues i akredituar” nga Qendra Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm ose nga një institucion tjetër i barasvlefshëm në një shtet tjetër të Bashkimit Evropian. Në rastet kur nuk është i akredituar, ofruesi ka një marrëveshje me një ofrues të akredituar nga Qendra Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm ose nga një institucion tjetër i barasvlefshëm në një shtet tjetër të Bashkimit Evropian, ku subjekti përgjegjës, sipas ligjit, për plotësimin e kushteve/kritereve dhe ofrimin e shërbimit, është ofruesi i akredituar.

9. Për aktivitetet *e-Learning*:

- a) ofruesi siguron përdorimin e materialeve didaktike në mënyrë të vazhdueshme dhe të përsëritshme, me anë të teknologjive multimediale, nëpërmjet lidhjes me internetin;



- b) ofruesi përdor një platformë teknologjike, e cila i dedikohet edukimit e garanton përdorimin pa pasur nevojë për orare të caktuara apo të qënit të pranishëm në vende të përcaktuara që më parë;
  - c) platforma teknologjike siguron përdorimin e lehtë të kurseve, regjistrimin e përdoruesve, mundësinë për dhënien e pëlqimit për privatësinë dhe trajtimin e të dhënave të përdoruesve, verifikimin e veprimeve të kryera nga përdoruesit në platformë dhe të jetë në gjendje të masë nivelin e përvetësimit të kurseve nga përdoruesit nëpërmjet testeve vlerësuese dhe testeve për shkallën e pëlqimit të çdo kursi edukues;
  - ç) platforma teknologjike parashikon një apo më shumë module të edukimit/të formimit, si dhe procese të ndërmjetme vetëvlerësimi;
  - d) verifikimi i pjesëmarrjes sigurohet me anë të testeve për lëndët e dhëna dhe garantohe nga kontrolli i veprimeve të kryera nga sistemi. Përveç këtyre, parashikohen edhe verifikime të veçanta të identitetit të profesionistit.
10. Për aktivitetet e edukimit në distancë, sinkron (të njëkohshëm), pjesëmarrja në leksione ose sesione edukuese, që zhvillohen larg vendit ku është profesionisti, arrihet nëpërmjet përdorimit të një platforme multimediale të dedikuar (klasa virtuale, *webinar-e*), nëpërmjet lidhjes me internetin.
  11. Pjesëmarrja e njëkohshme parashikon lidhjen në internet të pjesëmarrësve në orare të caktuara që më parë nga programi mësimor e garantimin e një niveli të lartë ndërveprimi ndërmjet lektorëve/tutorëve dhe pjesëmarrësve.
  12. Çdo orë mësimi, përfshirë edhe ndërhyrjet e pjesëmarrësve, regjistrohet dhe është e disponueshme për t'u verifikuar, përdorur apo përsëritur në një moment tjetër.
  13. Pjesëmarrja individuale në aktivitet verifikohet me anë të regjistrimit të lidhjeve *on-line* në platformë gjatë orës së mësimi.
  14. Verifikimi i dijeve bëhet nëpërmjet testit që kryhet në përfundim të sesionit.

15. Ofruesi analizon ndryshimet te pjesëmarrësit (njohuritë, praktikat ose përfitimet e përfituesve), të arritura si rezultat i të gjitha aspekteve të aktivitetit të edukimit të vazhdueshëm.
16. Ofruesi përdor mjete vlerësuese të procesit të zbatimit të aktivitetit (p.sh.: ambienti, kohëzgjatja, numri i temave, burimet e përdorura).
17. Ofruesi identifikon, planifikon e zbaton ndryshimet e nevojshme ose të dëshiruara në aktivitet (p.sh.: planifikuesit, trajnuesit, infrastrukturën, metodat, burimet, mjetet, ndërhyrjet), që janë të nevojshme për përmirësimin e cilësisë së aktiviteteve të ardhshme të edukimit të vazhdueshëm.
18. Ofruesi siguron dokumentimin efikas të pjesëmarrësve në aktivitet.
19. Për aktivitetet e edukimit në distancë, ofruesi vërteton një përvetësim nga pjesëmarrësit deri në 70 % të njohurive të reja nga ndjekja e aktivitetit të edukimit në distancë (përqindja kaluese).
20. Ofruesi siguron përkthim për pjesëmarrësit në rastet kur aktiviteti apo një pjesë e tij zhvillohen në gjuhë të huaj.

#### **IV.2. Procedura e akreditimit të ofruesit**

21. Ofruesi, bazuar në fushën e tij të ekspertizës e të eksperiencës, aplikon për akreditim të kufizuar ose të pakufizuar. Akreditimi i kufizuar kërkohet për shërbime specifike të kujdesit shoqëror, për kategori të veçanta të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror ose për një lloj specifik të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm.
22. Procesi i akreditimit fillon me paraqitjen e kërkesës për akreditimin e përkohshëm.
23. Kërkesa, në kuptim të pikës 21, të këtij kreu, përfshin:
  - a) të dhënat për identifikimin e ofruesit e statusin ligjor sipas aneksit nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij; dhe
  - b) dokumentet provuese dhe shoqëruese, sipas aneksit nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

24. Qendra Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm miraton formularin e gatshëm të kërkesës, sipas pikës 23, të këtij kreu.
25. Kërkesa për akreditim shoqërohet me pagesën e tarifës së përcaktuar nga Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm, sipas procedurës së përcaktuar nga ky bord për aktivitetet e edukimit të vazhdueshëm.
26. Qendra Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm vlerëson përputhshmërinë me kriteret e akreditimit e vendos miratimin e akreditimit të përkohshëm apo refuzimin e tij.
27. Për marrjen e vendimit, Qendra Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm kryen vizita monitoruese në vendin e ushtrimit të veprimtarisë së kërkuesit për të verifikuar plotësimin e kriterëve të akreditimit apo monitorime të aktiviteteve të caktuara për verifikimin e standardeve të akreditimit.
28. Vendimi merret dhe i njoftohet kërkuesit brenda 3 (tre) muajve nga paraqitja e kërkesës të plotë nga ofruesi. Në rastet e refuzimit të kërkesës për akreditim, ofruesi riparaqet kërkesë pas një periudhe 3- (tri) mujore nga njoftimi i vendimit të refuzimit.
29. Akreditimi i përkohshëm është i vlefshëm për një periudhë 24-mujore nga njoftimi i vendimit, sipas pikës 28, të këtij kreu.
30. Pas një periudhe prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh nga njoftimi i vendimit për akreditimin e përkohshëm, ofruesi paraqet kërkesë për akreditimin 5- (pesë) vjeçar. Për këtë qëllim, së bashku me kërkesën, përditëson dokumentet e paraqitura së bashku me kërkesën për akreditimin e përkohshëm dhe paraqet një raport të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm të kryera gjatë periudhës nga akreditimi i përkohshëm.
31. Qendra Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm vlerëson përputhshmërinë me standardet e kriteret e akreditimit dhe, për këtë qëllim:
  - a) verifikon përmbushjen e kriterëve në kryerjen e aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm të zhvilluara nga ofruesi gjatë periudhës së akreditimit të përkohshëm;
  - b) kryen vizita monitoruese në vendin e ushtrimit të veprimtarisë së kërkuesit për të verifikuar plotësimin e kriterëve të akreditimit

- apo monitorim e veprimtarive të caktuara të akreditimit për verifikimin e standardeve të akreditimit;
- c) mbështetet në gjetjet e monitorimit të vazhdueshëm të kryer gjatë periudhës të akreditimit të përkohshëm.
32. Konkluzionet e nxjerra nga verifikimet paraqiten në një raport përfundimtar vlerësimi, përpara marrjes të vendimit përfundimtar.
33. Qendra Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm, brenda 6 (gjashtë) muajve nga paraqitja e kërkesës të plotë, vendos miratimin e akreditimit përfundimtar apo refuzimin e tij. Në rast refuzimi, përveç arsyesimit, përfshin edhe sugjerimet përkatëse për përmirësimin e veprimtarisë, më qëllim përmbushjen e standardeve. Në rastet e refuzimit të kërkesës për akreditim, ofruesi riparaqet kërkesën brenda 3 (tre) muajve nga njoftimi i vendimit të refuzimit.
34. Akreditimi përfundimtar është i vlefshëm për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh nga njoftimi i vendimit sipas pikës 28, të këtij kreu.
35. Për rinovimin e akreditimit përfundimtar, ofruesi paraqet një kërkesë rinovimi, jo më vonë se 8 (tetë) muaj para datës së përfundimit të vlefshmërisë të tij. Dispozitat e pikave 21 deri në 33 të këtij kreu zbatohen përshtatshmërisht edhe për rinovimin e akreditimit përfundimtar.
36. Lista e ofruesve të akredituar, përfshirë afatin dhe përmbajtjen e akreditimit, bëhet publike në faqen zyrtare të internetit të Qendrës Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm.

#### **V. Monitorimi i ofruesit gjatë periudhës së vlefshmërisë të akreditimit**

1. Qendra Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm kryen monitorimin në vazhdim të përputhshmërisë me standardet e kriteret e akreditimit të çdo ofruesi të akredituar, pavarësisht nga lloji i akreditimit të dhënë.
2. Për monitorimin, sipas pikës 1, të këtij kreu, Qendra Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm:
  - a) verifikon zbatimin e standardeve të akreditimit për të paktën 10 % të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm të zhvilluara nga ofruesi në një vit;



- b) monitoron përputhshmërinë me standardet e kriteret e tjera të paktën 1 (një) herë në vit.
3. Pas çdo monitorimi të kryer, Qendra Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm harton raportin e monitorimit, ku paraqet gjetjet e monitorimit, parregullsitë e konstatuara dhe rekomandimet për ndreqjen e parregullsive, si dhe afatet kohore për këtë. Raporti i monitorimit i njoftohet ofruesit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga përfundimi i misionit.
  4. Në bazë të monitorimit vjetor, Qendra Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm harton një raport vlerësimi vjetor për secilin nga ofruesit e akredituar. Raporti i vlerësimi i njoftohet ofruesit e Bordit të Edukimit të Vazhdueshëm.
  5. Në rast së gjatë misioneve të monitorimit vërehen shkelje të standardeve dhe të kriterëve të akreditimit, Qendra Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm merr vendim për anulimin e përkohshëm apo përfundimtar të akreditimit të dhënë.
  6. Vendimi për anulimin e përkohshëm të akreditimit merret në rast të konstatimit të shkeljeve të lehta dhe vendoset për periudhën deri në ndreqjen e shkeljeve, por jo me shumë se deri në 12 (dymbëdhjetë) muaj.
  7. Anulimi përfundimtar vendoset në rastin e konstatimit të shkeljeve të rënda apo përsëritjes së (3) tri shkeljeve të lehta brenda një periudhe 12- (dymbëdhjetë) mujore të veprimtarisë.
  8. Do të konsiderohen shkelje të lehta, sipas pikave 6 e 7, të këtij kreu:
    - a) ndryshimet në programin e aktiviteteve, të cilat cenojnë cilësinë e tij e ndikojnë në përlllogaritjen e krediteve të miratuara;
    - b) keqpërdorimi i emrit të institucionit akreditues dhe i krediteve të njohura prej tij;
    - c) vlerësimi negativ i shumicës së pjesëmarrësve për më shumë se dy aktivitete për përmbajtjen e temave të veçanta ose nivelin pedagogjik të paraqitjes së këtyre temave;
    - ç) mosparaqitja e dokumentacionit të nevojshëm për fazën pas aktivitetit apo mosnjoftimi i Qendrës Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm për ndryshimet e të dhënave të deklaruara.

9. Në rastet e anulimit përfundimtar të akreditimit ofruesi rikërkon akreditimin fillestar pas një periudhe prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh nga njoftimi i vendimit të anulimit.

## **VI. E DREJTA E ANKIMIT**

1. Ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të Qendrës Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm, sipas këtij vendimi, paraqitet ankim administrativ.
2. Ankimi paraqitet dhe shqyrtohet sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.
3. “Organi epror”, në procedurën e shqyrtimit të ankimit administrativ, në kuptimin e Kodit të Procedurave Administrative, është Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm.
4. Afati për shqyrtimin e ankimit dhe njoftimin e vendimit është 30 (tridhjetë) ditë nga paraqitja e ankesës.

## **VII. EKSPERTËT E PAVARUR**

1. Ekspertët e pavarur, sipas pikave 17 e 25, të kreut III.2, të këtij vendimi, përzgjidhen nga Qendra Kombëtare për Edukimin të Vazhdueshëm nga lista e miratuar e ekspertëve të secilës fushë.
2. Lista e ekspertëve të secilës fushë miratohet nga Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm e përditësohet çdo 2 (dy) vjet, në bazë të një procedure të hapur aplikimesh.
3. Eksperti i përzgjedhur nga Qendra Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm nuk përfshihet në planifikimin, organizimin e zbatimin e aktivitetit që vlerësohet prej tij. Çdo ekspert i përzgjedhur para kryerjes së një detyre të caktuar deklaron paraprakisht çdo konflikt të mundshëm interesi me ofruesin e aktivitetit të edukimit të vazhdueshëm.
4. Qendra Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm paguan ekspertët e pavarur për punën e kryer prej tyre, bazuar në përcaktimin e orëve të punës e sipas tarifave të miratuara nga Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm.

5. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Qendra Kombëtare për Edukimin e Vazhdueshëm dhe Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

**Në mungesë dhe me porosi**

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**ERION BRACE**

**MINISTRI I SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE**

**OGERTA MANASTIRLIU**

**ANEKSI NR.1**  
**TË DHËNAT PËR IDENTIFIKIMIN E OFRUESIT**  
**DHE TË AKTIVITETIT TË EDUKIMIT TË VAZHUESHËM**

**I. Formulari i kërkesës së akreditimit të një aktiviteti të edukimit të vazhdueshëm plotësohet me këto të dhëna:**

1. Të dhënat e identifikimit të ofruesit të aktivitetit, statusit të tij juridik e kontaktet përkatëse të ofruesit e personit përgjegjës për aktivitetin;
2. Lloji i aktivitetit e titulli i aktivitetit;
3. Fusha që mbulon aktiviteti;
4. Data e zhvillimit, vendi ku zhvillohet, kohëzgjatja në ditë dhe në orë efektive;
5. Numri i pjesëmarrësve;
6. Informacion për rezultatet e vlerësimit të nevojave të kryera për atë aktivitet e metodat e përdorura për vlerësimin e nevojave;
7. Qëllimi i aktivitetit dhe objektivat e ndara për njohuritë e profesionistëve/aftësitë dhe qëndrimet e profesionistëve;
8. Të dhëna për trajnerët/lektorët që do të përfshihen në aktivitet;
9. Kategoria kryesore e profesionistëve pjesëmarrës në aktivitet, për të cilët është përgatitur aktiviteti;
10. Informacion për formën e zgjedhur për vlerësimin e organizimit të aktivitetit nga pjesëmarrësit;
11. Informacion për formën e zgjedhur për vlerësimin e procesit e të mësuarit të pjesëmarrësit;
12. Informacion për gjuhën që do të përdoret gjatë aktivitetit;
13. Metodatat pedagogjike që do të përdoren;
14. Informacion për materialet didaktike që do të përdoren në këtë aktivitet;

15. Burimet e financimit dhe nëse pjesëmarrësit do të paguajnë një tarifë apo jo.

**II. Përveç sa parashikohet në nënndarjen I, formulari i aplikimit për aktivitetet e edukimit në distancë përmban edhe këto të dhëna të detyrueshme:**

1. Informacion për formatin me të cilin do të përdoret materiali nga pjesëmarrësit: *Windows, MacOS*; lexues *DVD*-je;
2. Kontaktet për ofrim mbështetjeje teknike për pjesëmarrësit në rastin e aktiviteteve që përdorin teknologjinë e informacionit;
3. Çdo material (libër, *software* etj.) që nevojitet të ketë pjesëmarrësi.

**III. Dokumentet provuese dhe shoqëruese**

1. Jetëshkrimi i lektorëve/trajnerëve të përfshirë në aktivitet ose në përgatitjen e kurrikulave të tij;
2. Pyetësi i vlerësimit të organizimit të aktivitetit;
3. Pyetësi i vlerësimit të procesit të të mësuarit të pjesëmarrësit në aktivitet (nëse do të ketë vlerësim të tillë);
4. Programi i detajuar i aktivitetit;
5. Të gjitha materialet didaktike që do të përdoren për aktivitetin, si: kurrikula, materiale reference, prezantime dhe materiale mbështetëse për pjesëmarrësit;
6. Kopja e firmosur nga personi i kontaktit të deklaratës për konfliktin e interesit (nëse ka konflikt interesi).
7. Kopja e certifikatës për profesionistët pjesëmarrës në aktivitet.

**ANEKSI NR.2**  
**KREDITET PËR AKTIVITETET E EDUKIMIT TË VAZHDESHËM**  
**QË AKREDITOHEN**

<b>Kriteret e përgjithshme</b>		
Një aktivitet i edukimit të vazhdueshëm nuk vlerësohet me më shumë se 50 kredite.		
Një aktivitet i edukimit të vazhdueshëm nuk vlerësohet me më shumë se 6 kredite në ditë.		
<b>Kriteret e veçanta</b>		
<b>NR.</b>	<b>EMËRTIMI I AKTIVITETIT</b>	<b>KREDITET</b>
1	Konferencë shkencore	1 orë = 1,5 kredite <i>(përlllogaritja kryhet duke shmangur kohën e pushimeve, të hapjes e të mbylljes së aktivitetit)</i>
2	Konferencë (maksimumi 3 ditë)	1 orë = 1 kredit <i>(përlllogaritja kryhet duke shmangur kohën e pushimeve, të hapjes e të mbylljes së aktivitetit)</i>
3	Trajnimi (1 ditë deri në 3 muaj)	1 orë = 0.5 kredite <i>(përlllogaritja kryhet duke shmangur kohën e pushimeve, të hapjes e të mbylljes së aktivitetit)</i>
4	<i>Workshop (1- 2 ditë)</i>	1 orë = 0.5 kredite <i>(përlllogaritja kryhet duke shmangur kohën e pushimeve, të hapjes e të mbylljes së aktivitetit)</i>
5	Prezantim leksioni (maksimumi 2 orë)	1 orë = 1 kredit
6	Grup rishikimi (1- 2 orë)	1 orë = 1 kredit
7	Edukim në distancë	3 kredite në ditë



**ANEKSI NR.3**  
**TË DHËNA PËR OFRUESIT E AKTIVITETIT NË VAZHDIM**

**I. Përmbajtja e formularit të kërkesës për akreditimin fillestar të ofruesit të shërbimeve të edukimit të vazhdueshëm**

1. Kërkesë për akreditim, e cila specifikon llojin e akreditimit që kërkohet.
2. Informacion për statusin ligjor të ofruesit.

**II. Dokumentet provuese dhe shoqëruese të kërkesës për akreditimin fillestar të ofruesit të shërbimeve të edukimit të vazhdueshëm**

1. Vërtetim i pronësisë, ose kontratë shitblerjeje, ose kontratë qiraje, ose kontratë dhënieje në përdorim të ambientit, ku ushtron aktivitetin ofruesi që do të akreditohet.
2. Dokumentet që provojnë statusin ligjor të ofruesit dhe objektin e veprimtarisë.
3. Bilanci financiar i vitit të fundit.
4. Kontratat e punës/shërbimit/konsulencës për çdo punonjës, anëtarët e komitetit shkencor, koordinatori/koordinatorët shkencorë apo persona të tjerë që lidhen me menaxhimin e aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm. Këto kontrata përfshijnë përshkrimin e punës për çdo person.
5. Lista e punonjësve e vërtetuar nga zyra e tatimeve.
6. Plani i detajuar i aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm për 6 (gjashtë) muaj deri në 1 (një) vit nga data e aplikimit për akreditim të ofruesit. Plani i aktiviteteve të shoqërohet me vlerësimin e nevojave të profesionistëve për edukimin e vazhdueshëm, sipas kategorive të tyre.
7. Dokumenti që vërteton pagesën e tarifës së akreditimit.

NR.PROT. 5168/1  
DATË 29.10. 2020

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES  
SOCIALE  
QENDRËS KOMBËTARE PËR EDUKIMIN E  
VAZHDUESHËM  
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

**Sekretari i Përgjithshëm**

**Engjell AGAÇI**

